



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENSIA KOMBËTARE E MJEDISIT



PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

**VLERËSIMI I THELLUAR I NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PROJEKTIN "NDËRTIMI,
INSTALIMI DHE SHFRYTËZIMI CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË SI DHE
PRODHIMI ENERGJISE ELEKTRIKE NGA KETO CENTRALE",**

PROJEKTI EOLIK KAPPET

**NËNZONA KAPSHICË (BASHKIA DEVOLL) DHE NËNZONA E PRETUSHË (BASHKIA
POGRADEC, QARKU KORCË)**

Maj 2022

HARTUAR

Ing. Edlir Vokopola	- Çertifikatë, Nr. Indetifikues 516
Ing. Dritan Gorica	- Çertifikatë, Nr. Indetifikues 513
Ing. Emanuela Arifi	- Çertifikatë, Nr. Indetifikues 353

POROSITËS



HERA Sh.p.k

NIPT: K71819034H

Rr. "Reshit Petrela", Sek. 1; Kat. 9, Ap. D; Tirane

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	5
SHKURTIME	6
1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-së DHE METODIKA E ZBATUAR	7
1.1 Parathënie.....	7
1.2 Përshkrimi i qëllimit dhe objektivat e raportit të thelluar të VNM-së.....	7
1.3 Përshkrimi i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhen me projektin e propozuar	8
2. PËRSHKRIMI JOTEKNIK I PROJEKTIT TË PARKUT EOLIK KAPPET	9
2.1 Përshkrimi i qëllimit të projektit të Parkut Eolik KAPPET.....	9
2.2 Vendndodhja e projektit të Parkut Eolik KAPPET	9
2.3 Informacion mbi qëndrat e banuara në zonën e projektit	12
2.3.1 Të dhëna të përgjithshme Bashkia Pogradec.....	12
2.3.2 Të dhëna të Bashkisë Devoll	13
2.4 Ndikimit në Mjedis dhe Plani i Ndërhyrjeve	15

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Planimetria e Përgjithshme e vendndodhjes së Parkut Eolik KAPPET	11
Figura 2: Foto të fshatrave Pretushe dhe Blace në nënzonë e pare të projektit.....	12
Figura 3: Relievi i shperndarjes simuluese te aerogjeneratoreve dhe afersia me qendrat e banuara nenzona e pare.	13
Figura 4: Foto të fshatrave Kapshtice dhe Vishovice në nënzonë e dyte të projektit	14
Figura 5: Relievi i shperndarjes simuluese te aerogjeneratoreve dhe afersia me qendrat e banuara nenzona e dyte.....	14

HYRJE

Zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.

Përdorimi i fuqisë së erës për të gjeneruar energji elektrike jo vetëm si burim energjie por edhe në pikpamje mjedisore është një nga më të pastrat dhe mënyrat më të mirat e të qëndrueshme pasi nuk prodhon ndotje toksike apo emetimet e gazeve serë që ndikojnë në ngrohjen globale.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030¹ për Shqipërinë, i përcaktin Burimet e Rinovueshme të Energjisë (BRE) si një instrument për të rritur energjinë e prodhuar në vend por edhe si një skenar nëpërmjet të cilit Shqipëria do të përmbushë angazhimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë duke arritur objektivin e 38% të kontributit të energjive të përtëritshme përkundrejt totalit të energjisë së prodhuar në vend në vitin 2018.

Në këtë kuadër, konsideruar vecorite e përgjithëshme klimatike të Shqipërisë dhe sidomos të vecorive të regjimit të erës, studjuese shqiptare e të huaj kanë bërë përpjekjet e tyre për të vlerësuar rezervat energjitike të erës si dhe gjetjes së rrugëve me efikase për përdorimin e saj si burim energjie. Studimet e kryera deri tani dhe sidomos ato që po zhvillohen dy vitet e fundit kanë treguar që Shqipëria ka mundësi reale për shfrytëzimin e erës si burim i gjenerimit të energjisë elektrike. Në disa nga punimet dhe studimet e kryera nga fizikanë, meteorologë e energjetistë janë vlerësuar zonat me të favorëshme nga pikpamja energjetike ("promising area"), si dhe janë përcaktuar tregueset dhe parametra meteorologjike që shërbejnë si inpute në modelimin e rrymave ajrore në rajone me topografi e orografi të ndryshme².

¹ E miratuar me VKM 480, 31/07/2018

² "Development of Wind Power Projects in Albania-Ëind Siting Study", Golder Associates S.r.l.; June 2021



SHKURTIME

ERE	Enti Rregullator i Energjisë
BRE	Burime të Rinovueshme të Energjisë
VKM	Vendim I Këshillit të Mnistrave
MW	Mega Watt instaluar
MWh	Mega Watt gjeneruar
MIE	Ministria Infrastruktures dhe Energjise
MTE	Ministria Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ARM	Agjensia Rajonale e Mjedisit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
AKZM	Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-së DHE METODIKA E ZBATUAR

1.1 Parathënie

Kompania "HERA" Shpk, me angazhimin e shumë specialistëve të huaj dhe vëndas, ka ndërmarë një studim të plotë për hartur një projekt me synim gjenerimin e energjise elektrike nëpërmjet impiantiti eolike KAPPET.

Kompania "HERA" Shpk është licensuar nga Enti Rregullator Energjise Elektrike (ERE) me Vendim të bordit drejtues Nr. 61, datë 2/11/2007 "Për Ndërtimin, Instalimin dhe Shfrytëzime Centraleve Elektrike me Erë si Dhe Prodhimin e Energjisë Elektrike Nga Keto Centrale", në zonën e Kapshtices (Bashkia Devoll) dhe në zonën e Pretushës (Bashkia Pogradec të qarkut të Korçës), përndryshe projekti i quajtur "Parku Eolik KAPPET".

I gjithë dokumentacioni për projektin KAPPET është mbështetur në Ligjin 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike," i ndryshuar, dhe Rregullorja mbi Procedurat e Licensimit të EREs.

1.2 Përshkrimi i qëllimit dhe objektivat e raportit të thelluar të VNM-së

Ky dokument është përpiluar duke u bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, VKM-në nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, dhe Vendimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Thelluar (VNM) të Agjensise Kombëtare të Mjedisit (AKM), Komision 10, datë 01.03.2022 në vijim të aplikimit AN110120220005 të subjekti HERA shpk për VNM paraprake për Projektin "Ndërtimin, Instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale – Parku Eolik KAPPET dhe reflekton arsyetimin e AKM për të cilin ky aktivitet duhet të nënshtrohet Procedurës së Thelluar të VNM-së, si dhe qëndrimet e drejtorive Teknike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe institucioneve të tjera.

Pavarësisht nga potenciali që paraqet ky projekt, ka një seri arsyes mjedisore dhe ndikime që lidhen me prodhimin e energjisë nga era që duhet të njihen dhe adresuar. Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar për të ardhur në ndihme vendimmarrësve dhe zhvilluesit për identifikimin e ndikimeve të mundshme mjedisore të projektit të propozuara, për të vlerësuar alternativën, qasjet, dhe për të hartuar dhe përfshirë parandalimin, zbutjen e duhur, si masat e menaxhimit dhe monitorimit të këtyre ndikimeve.

Qëllimi i këtij studimi i paraqitur në formën e një Raporti të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është që të identifikojë, vlerësojë, propozojë masa për eliminimin/zbutjen dhe monitorimin në vijimësi të impaktit të mundshëm negativ në mjedis të Projektit Eolik KAPPET. Kjo VNM është konsideruar si një mjet parashikues, për të analizuar objektivisht gjasat e efekteve të rëndësishme të një zhvillimi pozitiv dhe/ose negativ dhe ndihmuar vendimmarrësit që ti japin këtij projekti rrugën e mëtejshme të zhvillimit.

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Legjislacionit Shqiptar dhe Direktivat e Bashkimit Europian për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, me akte juridike ligjore dhe nenligjore specifike që rregullojnë ushtrimin e aktivitetit të investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Objektivi kryesor i kësaj VNM-je konsiston në evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve në mjedis dhe masat zbutëse të këtij ndikimi për të siguruar një mjedis të qëndrueshem, gjatë fazave të

kryerjes së aktivitetit të ndrtimit të parkut eolik, deri në perfundim të aktivitetit dhe rehabilitimin e hapësirës së shfrytëzuar në gjëndje mjedisore të qëndrueshme në vitet pasardhëse. Nëpërmjet këtij studimi informojmë gjithashtu organet vendim-marres, mbi ndikimet në mjedis dhe përfitimet nga projekti i propozuar dhe se duke siguruar që zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike, nuk rezikon shëndetin dhe mireqenien e jetes së komunitet ku shtrihet projekti si dhe të atyre individëve të cilët liden dhe/ose varen drejtpërsëdrejti nga ose me këtë projekt dhe veprimtarinë e tij.

Ky objektivi kryesor ndahet në objektiva specifike si më poshtë janë renditur:

- Të evidentojë ndërthurjen dhe bashkerendimin e aktivitetit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe nderkombetar në fushën e mjedisit;
- Të përshkruaj vlerat natyrore dhe mjedisore në zonën ku do të zhvillohet projekti dhe të identifikojë statusin e mbrojtës së tyre;
- Të identifikojë ndikimet e mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime;
- Të lehtësojë vendim-marrjen e organeve kompetente planifikuese dhe mjedisore për projektin;
- Të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të ndikimeve në mjedis duke përfshirë publikun dhe aktoret e tjerë vendimmarrës;
- Të identifikojë kufizimet që rrjedhin nga kushte specifike, mundësitë dhe resurset të cilat do të influencojnë mbi mënyrën se si duhet të hartohen propozimet për zhvillimin e këtij projekti;
- Të harmonizojë ndikimet dhe përfitimet, përndryshe kur është rast, të efekteve të kombinuara të propozimeve të ndryshme për zhvillimin e veprimtarisë së propozuar me veprimtaritë ekzistuese.

1.3 Përshkrimi i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhen me projektin e propozuar

Legjislacioni aktual dhe përkatësisht Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, i ka dhënë një rëndësi të madhe të drejtës mjedisore dhe asaj për informim në fushën e mjedisit. Ekspertët kanë referuar edhe me të gjitha aktet dhe aktet nënligjore objekti i të cilave ndërpritet me vendin dhe llojin e projektit të propozuar sic janë renditur më poshtë:

- Ligji nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar
- Ligji nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”,i ndryshuar.
- VKM Nr.994, dt. 2.7.2008 “per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin”
- Udhezim nr.3, date 02.12.2013 “Per VNM dhe Lejet e Mjedisit”.
- Udhezim “Per miratimin e metodologjise se Vleresimit paraprak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”;

si dhe te gjithë legjislacionin qe lidhet me hartimin dhe zbatimin e ketij projekti.

2. PËRSHKRIMI JOTEKNIK I PROJEKTIT TË PARKUT EOLIK KAPPET

2.1 Përshkrimi i qëllimit të projektit të Parkut Eolik KAPPET

Qëllimi i projektit është realizimi i një centrali elektrik me erë i emërtuar “KAPPET” për prodhimin industrial të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme eolike (të erës), me fuqi të instaluar 150 MW + 10% të përbërë nga maksimalisht 87 aerogjeneratorë, si të specifikuar në Vendimin Nr. 61, datë 2.11.2007 të Bordit të Komsionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe të përmbledhur në Aneks C të Licensës së ERE Nr. 49, Seria NPM07P, me fuqi nominale njësi të parashikuar ndërmjet 2 MW dhe fuqi nominale të përgjithshme prej 150 plus 10% MW, ose me fuqi njësi nominale njesi 3 ose më shumë MW dhe fuqi të përgjithshme prej 150 plus 10% MW.

Sipas karakteristikave gjeomorfologjike, numrit dhe tipologjisë së kullave të gjeneratorëve eolikë që do të instalohen, vlerësohet që parku eolik të japë një prodhim elektrik jo më të ulët se 337,448 MWh në vit.

Duke u mbështetur në topografinë dhe morfologjinë e truallit si edhe në të dhënat e vlerësuara mbi erën, vlerësohet se impianti do të ketë një funksionim vjetor jo më të vogël se (duke mbajtur parasysh që si shpejtësi mesatare është llogaritur shpejtësia më e vogël e pritshme):

- 7,000 orë/vit
- 290 ditë/vit

Kjo do të thotë se impianti eolik i projektuar do të prodhojë energji gjatë një numri ditësh jo më të vogël se 290 ditë / vit.

2.2 Vendndodhja e projektit të Parkut Eolik KAPPET

Projekti do të zhvillohet në territorin e qarkut të Korçës i cili gjeografikisht shtrihet në zonën jug-lindore të Shqipërisë, me orjentim juglindje – veriperëndim, në kreshtat kodrinore përgjatë rrëzes së malit të Thatë në një lartësi gjeografike që varion nga 700 m derin në 1,300 mbi nivelin e detit.

Parku eolik në projekt do të shtrihet në dy zona të veçanta, të emërtuara më poshtë si “Nenzona Pretushe” dhe “Nenzona Kapshtica”.

1. “Nenzona Pretushe” përfshin territorin që shtrihet ne ish-komunat Cerrave dhe Vreshtaz ndërmjet vendbanimeve të mëposhtme:

- Blaca (në veri të parkut eolik të projektuar)
- Podgoria (në lindje të parkut eolik)
- Pretusha (në perëndim të parkut eolik).

Ne NJA-të Cerrave dhe Vreshtaz (ish-komunat Cerrave dhe Vreshtaz) sipërfaqja totale e kantierit per 43 aerogjeneratore do te jete 18 ha për bazamentet e aerogjeneratoreve dhe 15.6 ha, per rruget hyrese dhe lidhese. Në këtë Nenzonë projekti do të shtrihet në një sipërfaqe të projektuar prej **34 ha**; ndërsa zona e studiuar ne Masterplan per “Nenzonen Petrushe” përfshin një sipërfaqe prej rreth 2420 ha dhe shtrihet pjesërisht ne territorin e Njësise Administrative (NJA) Cerrave

(aktualisht bashkia Pogradec) dhe pjeserisht ne territorin e NJA Vreshtaz (aktualisht bashkia Maliq) të qarkut Korce.

2. **“Nenzona Kapshtica”** përfshin territorin e bashkisë Devoll (ish komuna Qender Bilisht ndërmjet vendbanimeve të mëposhtme:

- Vërniku (në veri të parkut eolik të projektuar)
- Kapshtica dhe Vishocica (në jug të parkut eolik)
- Bilishti (në perëndim të parkut eolik).

Ne bashkinë Devoll (ish komuna Qender Bilisht) sipërfaqja totale e kantierit për 44 aerogjeneratore do të jete 16 ha për bazamentet e aerogjeneratoreve dhe 10 ha për rruget hyrese dhe lidhese Në këtë Nenzonë projekti do të shtrihet në një sipërfaqe të projektuar prej 26 ha; ndërsa zona e studiuar ne Masterplan për “Nenzonen kapshticë” përfshin një sipërfaqe prej rreth 2485 ha dhe shtrihet ne territorin e bashkisë Devoll (ish komuna Qender Bilisht) të qarkut Korce.

Në total projekti do të shtrihet në një sipërfaqe prej rreth **60 ha** respektivisht në territoret e bashkive Pogradec, Maliq dhe Devoll.

Vija e jashtme e zonës së studiuar në totalin prej 4,905 ha për parkun eolik KAPPET korrespondon me kufirin e efektit minimal akustik të studiuar dhe të vlerësuar me 40 db.


Projekti parashikon instalimin e **87 kullave** mbi disa kreshta kodrinore dhe me një hapësirë ndërmjet turbinave të së njëjtës radhë të barabartë me të paktën 3 diametra (270-282 m) dhe një largësi të paktën 5 herë diametrin e rotorit (470 m).

Koordinatat e pikave të identifikuar provizorisht (pikat definitive do të jete produkt i projektit të zbatimit i cili do të përgatitet dhe paraqitet njëherazi me aplikimin për lejen e ndertimit të parkut eolik KAPPET) në Sistemin UTM WGS 84, për çdo gjenerator ajror, të ndara në **“Nenzonen Kapshtice”** dhe **“Nenzonen Pretushe”** jepen në tabelat e mëposhtme:

Për qëllimet e projekti dhe për të siguruar mundësinë e zgjedhjes më të mirë të vendosjes së aerogjeneratoreve, nga punimet topografike në terren janë trasuar gjithsej 105 pika nga 87 të kërkuara.



Figura 1: Planimetria e Përgjithshme e vendndodhjes së Parkut Eolik KAPPET



2.3 Informacion mbi qëndrat e banuara në zonën e projektit

Projekti i Parkut eolik KAPPET shtrihet në territorin e bashkive Pogradec, Maliq edhe Devoll të qarkut të Korçës.

2.3.1 Të dhëna të përgjithshme Bashkia Pogradec

ona gjeografike: Pogradeci kufizohet në veri me bashkinë Prrenjas, në perëndim me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Maliq, në juglindje me bashkinë Pustec, ndërsa në lindje me Republikën e Maqedonisë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Pogradecit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 61.530 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit



Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 90.976 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 548.77 km².

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Pogradec, Udënisht, Buçimas, Çërrave, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Pogradecit dhe qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 72 fshatra.

Në nënzonën Petrushë territoret në të cilat shtrihet Projekti dhe vendbanimet që ndodhen me afer zonës së projektit ndahen ndërmjet bashkisë Pogradec (fshatrat Cerrave, Pretushe dhe Blace) dhe bashkisë Maliq (fshatrat Vreshtaz Nizhavec).

Figura 2: Foto të fshatrave Pretushe dhe Blace në nënzonë e pare të projektit



Figura 3: Relievi i shperndarjes simuluese te aerogjeneratoreve dhe afersia me qendrat e banuara ne zona e pare.



2.3.2 Të dhëna të Bashkisë Devoll

Zona gjeografike: Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit



Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 26.716 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42.388 vetësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km².

Në nënzonën Kapshticë territoret në të cilat shtrihet Projekti dhe vendbanimet që ndodhen me afër zonës së projektit janë nën administrimin e bashkisë Devoll (fshatrat Kapshticë dhe Vishovicë).

Figura 4: Foto të fshatrave Kapshtice dhe Vishovice në nënzonë e dyte të projektit



Figura 5: Relievi i shperndarjes simuluese te aerogjeneratoreve dhe afersia me qendrat e banuara nenzona e dyte



Vendosja në largësi të përshtatshme e kullave nga banesat (minimalisht rreth 380 m) është një zgjidhje e projektit për të ulur pasojat e emetimit të zhurmës. Në largësi të tilla zhurma dinamike e krahëve është më e ulët se 40 dB(A). Në asnjë rast vendodhja e erogjeneratoreve nuk është më afër se 500 m largësi nga banesa ose objekte të tjera më të afërta të cilat ndodhen në zonën e projektit.

Veç këtyre parashikohet të realizohen ndërhyrje bonifikimi akustik pasiv në infrastrukturën e zonave të ndjeshme, në rast se nuk respektohen kriteret e dallueshme që sigurojnë mbrojtjen nga

ndotja akustike. Këto ndërhyrje parashikojnë kryesisht vendosjen e dritareve antizhurmë dhe vetëajrosëse me tregues të izolimit akustik të përcaktuar në përputhje me normat ISO 140/3-95, ISO 140/4-78, ISO 717/1-82 dhe përditësimet e tyre të mëvonshme.

2.4 Ndikimit në Mjedis dhe Plani i Ndërhyrjeve

Ky dokument është përpiluar duke u bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, VKM-në nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar.

Projekti do të zhvillohet në territorin e qarkut të Korçës i cili gjeografikisht shtrihet në zonën juglindore të Shqipërisë, me orjentim juglindje – veriperëndim, në kreshtat kodrinore përgjatë rrëzes së Malit të Thatë në një lartësi gjeografike që varion nga 700 m derin në 1,300 mbi nivelin e detit.

Parku eolik në projekt do të shtrihet në dy zona të veçanta, të emëtuara më poshtë si “Nenzona Pretushë” në territorin e bashkisë Pogradec dhe Maliq dhe “Nenzona Kapshtica” në territorin e bashkisë Devoll.

Në total projekti do të shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 60 ha respektivisht në territoret e bashkive Pogradec, Maliq dhe Devoll.

Vija e jashtme e zonës së studiuar në totalin prej 4,905 ha për parkun eolik KAPPET korrespondon me kufirin e efektit minimal akustik të studiuar dhe të vlerësuar me 40 db.

Qëllimi i këtij studimi i paraqitur në formën e një Raporti të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është që të identifikojë, vlerësojë, propozojë masa për eliminimin/zbutjen dhe monitorimin në vijimësi të impaktit të mundshëm negative në mjedis të Projektit Eolik KAPPET. Kjo VNM është konsideruar si një mjet parashikues, për të analizuar objektivisht gjasat e efekteve të rëndësishme të një zhvillimi pozitive dhe/ose negative dhe ndihmuar vendimarrësit që ti japin këtij projekti rrugen e mëtejshme të zhvillimit.

Objektivi kryesor i kësaj VNM-je konsiston në evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve në mjedis dhe masat zbutëse të këtij ndikimi për të siguruar një mjedis të qëndrueshem, gjatë fazave të kryerjes së aktivitetit të ndërtimit të parkut eolik, deri në perfundim të aktivitetit dhe rehabilitimin e hapësirës së shfrytëzuar në gjëndje mjedisore të qëndrueshme në vitet pasardhëse. Nëpërmjet këtij studimi informojmë gjithashtu organet vendim-marres, mbi ndikimet në mjedis dhe përfitimet nga projekti i propozuar dhe se duke siguruar që zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike, nuk rrezikon shëndetin dhe mireqenien e jetes së komunitet ku shtrihet projekti si dhe të atyre individëve të cilët liden dhe/ose varen drejtpërsëdrejti nga ose me këtë projekt dhe veprimtarinë e tij.

Ky objektivi kryesor ndahet në objektiva specifike si më poshtë janë renditur:

- Të evidentojë ndërthurjen dhe bashkerendimin e aktivitetit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe nderkombëtar në fushën e mjedisit;
- Të përshkruaj vlerat natyrore dhe mjedisore në zonën ku do të zhvillohet projekti dhe të identifikojë statusin e mbrojtjes së tyre;
- Të identifikojë ndikimet e mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në

mjedis duke propozuar njëkohsisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime;

- Të lehtësojë vendim-marrjen e organeve kompetente planifikuese dhe mjedisore për projektin;
- Të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të ndikimeve në mjedis duke përfshirë publikun dhe aktoret e tjerë vendimmarrës;
- Të identifikojë kufizimet që rrjedhin nga kushte specifike, mundësitë dhe resurset të cilat do të influencojnë mbi menyrën se si duhet të hartohen propozimet për zhvillimin e këtij projekti;
- Të harmonizojë ndikimet dhe perfitimet, përndryshe kur është rasti, të efekteve të kombinuara të propozimeve të ndryshme për zhvillimin e veprimtarisë së propozuar me veprimtaritë ekzistuese.

Proceset ndërtimore kryesore të zhvillimit të Parkut Eolik KAPPET do të përfshijnë:

- a. Instalimin e aerogjeneratorëve eolikë të instaluar mbi kullat tubolare;
- b. Linjat elektrike të nëndheshme me të gjitha mekanizmat e nevojshme të transformimit dhe seksionimit të tensionit;
- c. Nënstacioni i transformimit dhe lidhjes me rrjetin shpërndarës kombëtar të TL, ose të gjitha aparaturat (shkyçës, seksinonues, TA [transformator rryme], TV [transformator tensioni] etj.) të nevojshme për realizimin e lidhjes elektrike të impiantit.

Sic është dhe detajuar në pjesën përshkimore të këtij projekti, kohezgjatja e venies në përdorim të projektit KAPPET është parashikuar në rreth 24 muaj, ndërsa kohezgjatja e përdorimit me qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike është projektuar për 30 vjet.

Përzgjedhja e vendndodhjes së projektit për Parkun eolik KAPPET është bazuar mbi të dhënat e erës në këtë zonë. Vlerësimi i burimeve të erës zakonisht i referohet përlllogaritjes së shpejtësisë mesatare të erës dhe probabilitetit të përndarjes së saj në drejtim të zonave të ndryshme gjatë një periudhe disavjeçare.

Ndikimet në mjedis. Ndonse projekti nuk shtrihet në zonë të mbrojtur, por duke qënë se bën pjesë në “Zonën Tranzitore” të Rezervës Ndërkufitare të Biosferës Prespë”, në i kemi parë të rëndësishme ndikimet që ky projekt mund të shkaktojë në këtë zonë. Në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis të Projektit Eolik KAPPET, shoqëria ka marrë në konsideratë dispozitat e ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Rreziku që vjen nga projekti në këtë zonë konsiderohet i ulët pasi pjesa më e madhe e sipërfaqes së projektit shtrihet në pjesën e “Zonës Tranzitore” (zona me ngjyrë të verdhë) ose përndryshe zona fleksibël dhe rreziku nga zjarri si faktori kryesor që mund të shkaktojë dëme në mjedizin e zonës, për shkak të natyrës dhe teknologjisë së projektit, është shumë i ulët, ku mund kryhen praktika të mbarështimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Nga analiza në terren, ndonse një pjesë e parkut eolik KAPPET ndodhet në afërsi me kufirin me Greqinë, është konstatuar së projekti nuk sjell ndikime negative ndërkufitare pasi Energjia e erës

tani është një zgjidhje tërheqëse për problemin e gjenerimit të energjisë elektrike. "Karburanti" është i bollshëm, i decentralizuar dhe falas.

Nga pikpamja e gjeologjise krahinore, zona e basenit të Konçës been pjesë në Albanidet e brendëshme dhe i perket zonave strukturalo-tektonike Mirdita (Mr) dhe Gropave Molasike te Brendshme (GMB). Zona ne studim eshte prekur nga levizjet rrudhosese alpine te cilat karakterizohen nga levizje intensive tektonike që nga fillimi i periudhes se Pliocenit. Nga studimet gjeologjike në zonën e studiuar përvijohen disa sisteme prishjesh tektonike.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i projektit të propozuar të zhvillimit është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis është kryer identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarisë, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Ndertimi i parqeve eolike ose mullinjve me ere per prodhimin e energjise elektrike shtrihen në nje sipërfaqe relativisht te madhe por efektivisht nuk zënë sipërfaqe toke të madhe që të mos perdoret per qellime te tjera. Nga studime te ndryshme te kryera, nga ekspertet mjedisore eshte arritur ne konkluzionin se keto turbina, nuk duhet te ndertohen prane qendrave te banuara, prane infrastruktures ekzistuese ose te projektuar si aeroporte, baza ushtarake dhe mjedisore me biodiversitet te pasur.

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike burime i afërt uJOR në zonën e projektit është lumi i Devollit gjithsesi në distance nga zona ku shtrihet projekti; lumi i Devollit ka cilesi te mire te ujit.

Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet shume i paster duke qene se ndodhet në lartësi dhe larg zonave te banuara apo industriale dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit te ndertimit te impiantit nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes. Ndikimet e prishme priten gjatë fazës së ndërtimit kryeshisht të rrugëve te reja lidhëse për të cilat do të merren masa që të lagen në mënyrë të vazhdueshme për të ulur pluhurin gjatë levizjes së mjeteve.

Ne afersi te zonës së projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara. Projekti dhe shpërndarja e aerogjeneratorëve në terren është projektuar ne nivelin minimal të zhurmave që shkaktohen gjatë funksionimit në nivelin maksimal të pranuar prej 40 dB.

Zona ne afersi te projektit eshte e pabanuar dhe për rrjedhojë nuk gjenerohen mbetje. Zonat e banuar në afërsi të zonës së projektit karakterizohen nga nje numer popullsie e vogel dhe administrimi i mbetjeve bëhet nga bashkitë Pogradec, Maliq edhe Korçë dhe depozitohen në landfill-in e Maliqit.

Ndikimi në tokë lidhet vetem me punimet e ndërtimit të veprës kryeshit punime rrugore, bazamentet e vendosjes së aerogjeneratorëve dhe të kanaleve për shtrimin e kavove përcjellëse të energjisë.

Ndikimet negative në mjedis përmbledhen në:

- Germim i shtresave te tokes per instalimin e turbinave.
- Germim i siperfaqes se tokes per pershtatje per qellime transporti.
- Ngjeshje e tokes si pasoje e transportit dhe pajisjeve teknologjike.
- Erozion ne siperfaqet qe do te perdoren per transport.
- Ndotje e mundshme e ajrit nga pluhuri dhe si pasoje e avarive te makinerive, derdhje ne mjedis te lubrifikanteve.
- Vibracion si pasoje e germimeve per hapjen e themeleve dhe nga makinerite.

Nga operacionet e ndertimit do te demtohet bimesia kryesisht barishtore qe gjendet ne zonat e instalimit te turbinave dhe neper siperfaqet ku do te realizohet levizja e makinerive te transportit. Vlerat e humbura qe demtohen realisht nga operacionet e ndertimit jane ato qe gjenden ne siperfaqen e ndertimit te turbines (4m²) ndersa pjesa tjeter qe do demtohet gjate transportit ka aftesine të rigjenerohet pothuaj totalisht.

Gjate fazes se ndertimit ndikimet potenciale ne ajer mund te jene te konsiderueshme por nisur nga fakti qe zonat gjenden larg qendrave te banuara mund te thuhet se keto ndikime ne kete optike vleresohen si me pasoja negative minimale ne shendetin e njeritu apo ne standartet mjedisore te cilesise se ajrit.

Gjatë fazës së shfrytëzimit impiantit do të ketë asnjë emetim pasi gjenerimi i energjisë do të realizohet nëpërmjet fuqisë së rinovueshme të erës.

Nga ndërtimi i parkut Eolik KAPPET nuk do të ketë gjenerim të mbetjeve të rrezikshme apo zbustanca klasifikuara si të tilla. Vemendje kryesore gjate ketyre punimeve duhet te tregohet ne dy aspekte: (i) sistemimi i dherave te krijuar nga keto punime, (ii) sistemimi i brigjeve dhe shpateve per te evituar fillimin e erozionit.

Zhvilluesi qe ne fillimin e punimeve tregohet i gatshem me masat qe do te marri ne raste se do ndodhi ndonje rast i tille, i derdhjes se vajit te makinerive ne toke.

Studimi i hollesishem e strukturave gjeologjike, qendrueshmerise se tyre dhe masave te propozuar nga projektuesit e këtij imianti jane garanci qe keto probleme mjedisore do te jene minimale. Pra, mund te themi se nga ky aktivitet nuk pritet te kete ndikim mjedisor te matshem pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme.
- Nuk shkakton ndotje te tokes me shkarkime te ndryshme te lengeta apo te ngurta.
- Nuk ka shkarkime ne ajer te gazrave apo tymrave.

I vetmi ndikim ne shendetin e njerezve eshte ai i situatave jonormale qe mund te shkaktohen gjate ndertimit te veprave. Zbatimi i rregullave te sigurimit teknik e minimizon kete impakt. Personeli i cili do te punoje gjate shfrytezimit te vepres do te jete i kualifikuar dhe i trajnuar si per sigurimin teknik ashtu edhe per rreziqet e mundeshme.

Ndikimet në florë dhe në faunën e zonës janë klasifikuar si “mesatare” dhe të “ulta”.

Për lidhjen elektrike të parkut eolik parashikohet ndërtimi i një nënstacioni transformimi dhe lidhjeje (më poshtë edhe Impiant i dorëzimit) me antenën e Kabinës Primare të stacionit ekzistues të Zëmbllakut.

Shtyllat kryesore të cilat përbëjnë masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit si të identifikuar më sipër janë shtjelluar dhe përfshijnë: planifikimin e territorit, masat teknike – parandalimi i erozionit., masa estetike dhe punime inxhinierike, si dhe rimodelimi i zonës. Masa të tjera përfshijnë gjelbërimin nëpërmjet mbjelljes së bimëve autoktone, punimet biologjike - mbjelljet do të jene ne varesine e llojit pyjor qe do te perdorim fletor apo halor. Mbetjet do të grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Shoqëria do të kontaktojë me ofruesit e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve të bashkive si dhe me KRËM të qarkut Korçë për depozitimin e tyre në landfill-in e Korçës sipas llojit dhe tarifave respective për largimin dhe depozitimin e tyre.

Programi i Monitorimit te veprimtarise se shoqerise do te fokusohet ne mbledhjen e te dhenave mjedisore dhe perdorimin e tyre per permiresimin e menyres se operimit dhe korrigjimin apo marrjen e masave shtese te nevojshme per mbrojtjen e mjedisit. Programi i monitormit te veprimtarise do te zbatohet sipas fazave te zbatimit te projektit.

Shtyllat kryesore të masave për mbrojtjen e mjedisit do të bazohen në parimet kryesore të pranuar përgjithësisht: parandalimi, kontrolli, Ndërhyrjet, administrimi.

Eshte realizuar takimi me publikun ku eshte prezantuar projekti per ndertimin Parkut Eolik KAPPET. Gjate bisedes, banoret e zones jane vene ne dijeni per cdo ndikim qe sjell projekti dhe cdo mase qe eshte parashikuar ne raportin e VNM-se se thelluar, masa te cilat do te zbatohen gjate fazes se ndertimit dhe operimit te parkut. Gjithashtu u eshte treguar qarte gjurma e projektit, siperfaqen qe ze, parcelat qe kalon, etj.

Përfitimet vendore. Ndikimet e drejtpërdrejta ekonomike në territor të realizimit të parkut eolik do të jenë të dukshme dhe të prekshme si në punësimin e drejtpërdrejtë të banorëve të zonës dhepërfitime nga investime të mundëshme të përbashkëta të zhvilluesit dhe bashkive të interesuara.

Rekomandimet kryesore përfshijnë:

- Përdorimi i tokës me eficiencë për të minimizuar hapsirat të cilat do të përdorern në mënyrë të paktheshme në gjendjen e mëparshme.
- Menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta dhe te lengeta gjate ndertimit por edhe gjate mirembajtjes, duke i seleksionuar dhe menaxhuar nepermjet kontratave kontraktuale me subjekte te licensuar per kete qellim.
- Grumbullimi dhe menaxhimi i vajrave te perdorur sipas ligjeve ne fuqi, nepermjet kontratave me subjekte te licensuar per kete qellim.
- Shtrimi dhe betonimi i ambjenteve te punes dhe ndertimi i sistemit te kanalizimeve per orientimin e ujerave ose lendeve te tjera qe mund te gjenerohen gjate procesit te punes ne kantierin e ndertimit.
- Lidhja e nenstacionit me rrjetin e zones per furnizimin me energji elektrike te kryhet bazuar ne nje kontrate me specialistet e operatorit te transmetimit te energjise elektrike (OST).
- Te kryhet monitorimi i treguesve mjedisor per te shmager mbi kalim te normave te shkarkimit gjate ndertimit dhe te dhenat te dorezohen ne AKM – ARM Korçë- Elbasan – Beart cdo gjashte muaj.



- Aplikimi i ngjyrave te bazamentit te turbinave te pershtatshme per mjedisin e zones, helikat te jene te dukshme, si dhe te instalohen ndricues ne pikat me te larta te turbinave.
- Te shmanget ndertimi ne zona te cilat mund te jene biokorridore per shpendet.
- Te monitorohet zhurma ne qendrat e banuara si gjate ndertimit dhe gjate funksionimit te parkut Eolik.
- Te zbatohen kushtet e lejes mjedisore qe do te jepet nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe te ndryshimeve te tij.